



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 19 dhjetor 2019
Nr. ref.:RK 1490/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI99/19

Parashtrues

Persa Raičević

**Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të
Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje
me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-1-16-0038, të 2 majit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Persa Raičević nga Komuna e Istogut, me vendbanim në Budvë, Republika e Malit të Zi (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës e konteston Aktvendimin [AC-1-16-0038] e 2 majit 2019 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit) në lidhje me Aktgjykimin [C-IV-13-1641] e 9 tetorit 2015 të Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Specializuar).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar, përmes të cilit, sipas pretendimeve të parashtrueses së kërkesës, janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të saj të garantuara me nenet 7 [Vlerat], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 46 [Mbrojtja e Pronës], 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit], 51 [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale], 156 [Refugjatët dhe Personat e Zhvendosur Brenda Vendit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta); si dhe të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ); nenet 1, 2 dhe 8 të Kartës Sociale Evropiane; dhe nenin 11 të Konventës për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 14 qershor 2019, parashtruesja e kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
6. Më 18 qershor 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Remzije Istrefi-Peci dhe Safet Hoxha.
7. Më 11 korrik 2019, Gjykata njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ajo që të dërgojë dokumente shtesë në Gjykatë.
8. Më 30 korrik 2019, parashtruesja e kërkesës i dorëzoi me postë dokumentet e kërkuara në Gjykatë.
9. Më 7 nëntor 2019, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues, njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Në bazë të shkresave të lëndës rezultoi se parashtruesja e kërkesës ishte punonjëse e Ndërmarrjes Shoqërore “17 Nëntori” në Pejë (në tekstin e mëtejshëm: “N.SH. 17 Nëntori”) deri në vitin 1999.
11. Më 14 tetor 2005, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (në tekstin e mëtejshëm: AKM), mori vendim për likuidimin e “N.SH. 17 Nëntori” dhe si rezultat, përmes njoftimeve publike në mediet në gjuhën shqipe dhe serbe të 12 dhe 13 nëntorit 2005, si dhe përmes faqes së saj të internetit, njoftoi të gjithë paditësit dhe kreditorët potencial se dita e fundit për paraqitjen e kërkesave që ata konsiderojnë se i kanë ndaj “N.SH. 17 Nëntori” është 14 shkurti 2006.
12. Më 13 mars 2006, parashtruesja e kërkesës paraqiti kërkesën e saj pranë Komisionit të Likuidimit të AKM-së, përmes të cilës kërkoi që t’i paguhet shuma prej 15,000 euro në emër të pagave të papaguara.
13. Më 12 shtator 2006, Komisioni i Likuidimit i AKM-së i dërgoi parashtrueses së kërkesës një shkresë me anë të së cilës kërkoi që ajo ta specifikojë pretendimin e saj, përkatësisht të tregojë saktësisht periudhën për të cilën ajo e kërkon shumën prej 15,000 euro, si dhe të dorëzoi në Komisionin përkatës të gjitha dokumentet e tjera që i konsideron relevante në mbështetje të pretendimit të saj.
14. Me anë të një shkrese, parashtruesja e kërkesës iu përgjigj Komisionit të Likuidimit të AKM-së, duke thënë se ajo kishte kërkuar shumën e deklaruar prej 15,000 euro për pagat e papaguara për periudhën 1999/2006.
15. Më 16 korrik 2013, Autoriteti i Likuidimit i Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm: AKP) nxori Aktvendimin [PEJ139-01330], përmes të cilit refuzoi pretendimin e parashtrueses së kërkesës si të pabazuar.
16. Përmes këtij Aktvendimi, Autoriteti i Likuidimit i AKP-së theksoi se bazuar në pikën 1 të paragrafit 2 të nenit 36 (Kërkesat e pavlefshme dhe jo të rregullta) të Shtojcës së Ligjit 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm: Ligji i AKP-së) dhe nenin 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar (botuar në Gazetën Zyrtare Nr. 53 të 1976) e drejta e parashtrues përkatëse ishte parashkruar sepse e njëjta nuk kishte ndërmarrë ndonjë veprim juridik të kërkojë pagat e saj brenda afatit kohor të parashkrimit.
17. Më 3 gusht 2013, parashtruesja e kërkesës parashtrroi ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm: DHPGJS) kundër Aktvendimit [PEJ139-01330] të 16 korrikut 2013 të Autoritetit të Likuidimit të AKP-së, në të cilën ndër të tjera, theksoi se (i) kërkesa e saj nuk ishte parashkruar sepse ajo në fakt asnjëherë nuk ishte njoftuar për shkëputjen e marrëdhënies së saj të punës me N.SH-në përkatëse; (ii) ajo e kishte lëshuar vendin e saj të punës për shkak të rrethanave politike që ishin krijuar në Kosovë; dhe (iii) Aktvendimi i kontestuar i Autoritetit të Likuidimit ishte nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të saj të përcaktuara me “Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe dispozitat e Ligjit për Procedurën Administrative”.

18. Sipas shkresave të lëndës, më 3 shtator 2014, AKP-ja i dërgoi DHPGJS-së përgjigje ndaj ankesës së parashtrueses së kërkesës duke theksuar ndër të tjera, se: (i) kërkesa e parashtrueses përkatëse ishte parashkruar sepse ajo nuk kishte ndërmarrë asnjë procedurë ligjore kundër N.SH-së përkatëse në periudhën kohore 1999-2006; (ii) për më tepër që në këtë kontekst, nuk është relevante nëse parashtruesja e kërkesës ishte njoftuar ose jo për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, sepse bazuar në pikën 1 të paragrafit 2 të nenit 36 të Ligjit për AKP-së, nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar dhe nenit 361 (Kur fillon të rrjedhë parashkrimi) të Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore të vitit 1978, përcaktohet se parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkonte përmbushjen e detyrimit, përkatësisht dhe sipas letrës, nga momenti kur pagesat ndaj parashtrueses së kërkesës janë ndërprerë në vitin 1999; dhe (iii) fakti që parashtruesja e kërkesës nuk jetonte në Kosovë që nga viti 1999, *“nuk mund të konsiderohet një pengesë e pakapërcyeshme sipas nenit 383 të Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore [...]”*. Sipas shkresës, *“ankuesja mund të kishte parashtruar kërkesën me postë ose duke caktuar një përfaqësues ligjor në Kosovë”*, siç ka ndodhur më një numër të madh ankesash tjera të paraqitura në gjykatat e Kosovës.
19. Më 9 tetor 2015, Kolegji i Specializuar i DHPGJS nxori Aktgjykimin [C-IV-13-1641], përmes të cilit e refuzoi ankesën e parashtrueses së kërkesës si të pabazuar dhe e vërtetoi Aktvendimin e lartcekur të AKP-së, duke theksuar, ndër të tjera, se: (i) Njoftimi publik i AKM-së ishte bërë në përputhje me nenin 49 (Njoftimet dhe Shpalljet Publike) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/48 “Mbi Riorganizimin dhe Likuidimin e Ndërmarrjeve dhe pasurisë së tyre me autorizim administrativ të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit” (në tekstin e mëtejme: Rregullorja 2005/48); (ii) bazuar në paragrafin 3d të nenit 43 (Kalimi në likuidim) të Rregullores 2005/48, afati për dorëzimin e kërkesave ishte dy (2) muaj nga dita e njoftimit të dytë, dhe se bazuar në pikën 4.1 të paragrafit 4 të nenit 37 (Llogaritja dhe kompensimi i kërkesave) të Ligjit për AKP-në kërkesat do të konsiderohen të jenë të pasafatshme nëse janë dorëzuar pas afatit të përcaktuar me ligjet e aplikueshme; dhe (iii) parashtruesja e kërkesës i ishte drejtuar Komisionit të Likuidimit më 13 mars 2006, dhe rrjedhimisht pas afatit të përcaktuar për paraqitjen e ankesave në përputhje me njoftimin e AKM-së, për më tepër që, e njëjta nuk kishte arsyetuar në asnjë mënyrë vonesën përkatëse. Ky Aktgjykim përmes udhëzimit juridik specifikoi se i njëjti mund të apelohej në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së brenda njëzet e një (21) ditësh.
20. Më 24 shkurt 2016, parashtruesja e kërkesës parashtroi ankesë në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së kundër Aktgjykimit të lartcekur të Kolegjit të Specializuar. Përmes përgjegjës në padi të 23 gushtit 2016, AKP i propozoi Kolegjit të Apelit që ankesa e parashtrueses të kërkesës të refuzohet si e pabazuar.
21. Më 3 maj 2019, Kolegji i Apelit nxori Aktvendimin [AC-1-16-0038], përmes të cilit e refuzoi ankesën e parashtrueses së kërkesës si të papranueshme sepse, sipas arsyetimit e njëjta ishte e paaftashme. Kolegji i Apelit, theksoi se (i) bazuar në fletëkthesën e gjykatës përkatëse i ishte dorëzuar parashtrueses së

kërkesës më 27 janar 2016, ndërsa ankesa e saj kundër këtij Aktgjykimi në Kolegjin e Apelit ishte dorëzuar më 24 shkurt 2016, dhe rrjedhimisht pas afatit njëzet e një (21) ditorë të përcaktuar me Ligjin Nr. 04/L-033 për Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme për Çështje që ndërlidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Ligji për DHPGJS) brenda të cilit duhet të parashtrohen ankesat.

Pretendimet e parashtrueses së kërkesës

22. Parashtruesja e kërkesës pretendon se vendimet se kontestuarra të Kolegjit të Specializuar dhe të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, janë nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të saj të garantuara me nenet 7 [Vlerat], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 46 [Mbrojtja e Pronës], 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesioneve], 51 [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale], 156 [Refugjatët dhe Personat e Zhvendosur Brenda Vendit] të Kushtetutës; nenet 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe 14 (Ndalimi i diskriminimit) të KEDNJ-së; neneve 1, 2 dhe 8 të Kartës Sociale Evropiane; dhe nenit 11 të Konventës për Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj Gruas.
23. Parashtruesja e kërkesës pretendimet për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të saj, para Gjykatës i fokuson në ato të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
24. Parashtruesja e kërkesës fillimisht konteston mënyrën e publikimit të njoftimit të AKM-së përkitazi me afatin për paraqitjen e kërkesave. Në këtë aspekt, parashtruesja e kërkesës ndër të tjera thekson se (i) njoftimi i AKM-së mbi likuidimin dhe afatet për paraqitjen e kërkesave, i kishin pamundësuar asaj paraqitjen e kërkesës me kohë sepse i njëjti ishte publikuar në Kosovë dhe Serbi, duke u publikuar në gazetën “*Danas*” e cila ka tirazh të vogël, dhe “*vështirë mund të gjendet në Mal të Zi*”, ku ajo ishte duke jetuar; dhe (ii) Kolegji i Specializuar ka dështuar të vërtetojë përputhshmërinë e njoftimit me paragrafin 3d të nenit 43 të Rregullores 2005/48, i cili, ndër të tjera përcakton afatin prej dy (2) muajsh për dorëzimin e kërkesave prej publikimit të njoftimit të dytë.
25. Parashtruesja e kërkesës pretendon se Aktvendimi [PEJ139-01330] i 16 korrikut 2013 i Autoritetit të Likuidimit të AKM-së është i kundërligjshëm sepse i njëjti gabimisht kishte konstatuar se kërkesa e saj ishte parashkruar, duke marrë parasysh që asaj asnjëherë nuk i ishte shkëputur marrëdhënia e punës me “N.SH. 17 Nëntori”, dhe rrjedhimisht nuk kishte filluar të rrjedhë afati i parashkrimit.
26. Parashtruesja e kërkesës gjithashtu pretendon se Kolegji i Specializuar dhe Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, në nxjerrjen e Aktgjykimit [C-IV-13-1641] të 9 tetorit 2015 dhe Aktvendimit [AC-1-16-0038] të 3 majit 2019, respektivisht, kishin vërtetuar gabimisht gjendjen faktike, duke rezultuar në shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të saj. Parashtruesja e kërkesës gjithashtu pretendon se vendimet e lartcekura janë nxjerrë në shkelje të nenit 5 (Ndalimi i të gjitha llojeve të diskriminimit) dhe 67 (Ndërprerja e Kontratës së Punës

sipas fuqisë ligjore) të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji i Punës).

27. Parashtruesja e kërkesës në fund pretendon se i janë shkelur edhe të drejtat dhe liritë saj përkitazi me një vendim gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm.
28. Përfundimisht, parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata që kërkesa e saj e të shpallet e pranueshme dhe të konstatohet se Aktvendimi i kontestuar nuk është në përputhje me Kushtetutën duke e shpallur të pavlefshëm të njëjtin dhe duke e kthyer çështjen e saj në rivendosje.

Pranueshmëria e kërkesës

29. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.
30. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

„1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

(...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

31. Për më tepër, Gjykata gjithashtu i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç janë të përcaktuara me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa Individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 [Kërkesa Individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

32. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, e cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [AC-1-16-0038] e 2 majit 2019 të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesja e kërkesës gjithashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë themelore që ajo pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
33. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Paragrafi 2 i Rregullit 39 të Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtoj kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, rregulli 39 (2) përcakton që:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

34. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton që AKM kishte shpallur thirrjen për paraqitjen e kërkesave për “N.SH 17 Nëntori” deri më 14 shkurt 2006. Parashtruesja e kërkesës, pas këtij afati, përkatësisht me 13 mars 2006, iu kishte drejtuar AKM-së me kërkesën përkatëse. Kjo e fundit, përkatësisht Komisioni i Likuidimit i AKM-së, kishte refuzuar kërkesën e parashtrueses së kërkesës me arsyetimin se e drejta e saj bazuar në ligjet e aplikueshme ishte parashkruar. Këtë vendim, parashtruesja e kërkesës e kishte kontestuar në Kolegjin e Specializuar të DHPGJS-së, por kjo e fundit, përmes Aktgjykimit [C-IV-13-1641] të 9 tetorit 2015 e kishte refuzuar ankesën e parashtrueses së kërkesës si të pabazuar, duke vërtetuar Aktvendimin e Autoritetit të Likuidimit dhe duke theksuar ndër të tjera, se kërkesa e parashtrueses së kërkesës pranë AKM-së ishte dorëzuar edhe jashtë afatit të përcaktuar në njoftimin fillestarë të AKM-së. Parashtruesja e kërkesës ishte drejtuar në fund edhe në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së, megjithatë dhe sipas Aktvendimit të Kolegjit të Apelit, jashtë afatit njëzet e një (21) ditorë të përcaktuar përmes paragrafit 6 të nenit 10 të Ligjit për DHPGJS-në dhe të specifikuar edhe në këshillën juridike të Aktgjykimit [C-IV-13-1641] të 9 tetorit 2015 të Kolegjit të Specializuar.
35. Aktvendimin e Kolegjit të Apelit, parashtruesja e kërkesës e konteston në Gjykatë, duke pretenduar shkelje të një numri të drejtash themelore të garantuara me Kushtetutë dhe Konventa Ndërkombëtare, por duke e fokusuar argumentimin e saj në kundërligjshmërinë e (i) njoftimit të AKM-së për paraqitjen e kërkesave; (ii) Aktvendimit [PEJ139-01330] të 16 korrikut 2013 të Autoritetit të Likuidimit të AKM-së e i cili e kishte refuzuar kërkesën e

parashtrueses bazuar mbi afatet e parashkrimit; dhe (iii) Aktgjykimit [C-IV-13-1641] të 9 tetorit 2015 të Kolegjit të Specializuar dhe Aktvendimit [AC-1-16-0038] të 3 majit 2019 të Kolegjit të Apelit, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të dispozitave të ligjit të aplikueshëm.

36. Lidhur me pretendimet e lartcekura, Gjykata konsideron se (i) parashtruesja e kërkesës e ka ndërtuar rastin e saj mbi baza ligjshmërie, përkatësisht mbi vërtetimin e fakteve dhe interpretimin e gabuar të ligjit nga gjykatat e rregullta; për më tepër që (ii) të gjitha pretendimet e parashtrueses së kërkesës të paraqitura para kësaj Gjykate, janë paraqitur edhe para gjykatave të rregullta, dhe të njëjtat i kanë shqyrtuar dhe arsyetuar ato.
37. Më hollësisht, sa i përket çështjes së parë, përkatësisht pretendimeve përkitazi me ligjshmërinë e vendimeve të kontestuarra, Gjykata rikujton se ajo vazhdimisht ka theksuar se çështjet e tilla, nuk bien nën juridiksionin e Gjykatës, dhe si rrjedhojë, në parim, nuk mund të shqyrtohen nga Gjykata. (Shih, në këtë kontekst, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35; KI154/17 dhe 05/18, parashtrues të kërkesës, *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shogëria me përgjegjësi të kufizuar "Barbas"*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 gushtit 2019, paragrafi 60; dhe KI192/18, parashtruese e kërkesës, *Kompania Kosovare për distribuim dhe furnizim me energji, KEDS Sh.A.*, Aktvendim për papranueshmëri, i datës 16 gusht 2019, paragrafi 49).
38. Gjykata gjithashtu përmes praktikës së saj gjyqësore vazhdimisht ka theksuar se nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e "*shkallës së katërt*", që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih, rastin e GJEDNJ-së *García Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28; dhe shih, gjithashtu rastet e Gjykatës KI70/11, me parashtrues *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011; KI154/17 dhe 05/18, me parashtrues të kërkesës, *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shogëria me përgjegjësi të kufizuar "Barbas"*, cituar më lart, paragrafi 61; dhe KI192/18, me parashtruese të kërkesës, *Kompania Kosovare për distribuim dhe furnizim me energji, KEDS Sh.A.*, cituar më lart, paragrafi 50).
39. Gjykata gjithashtu, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, vazhdimisht ka theksuar, se në parim, dhe me përjashtim të rasteve në të cilat argumentohet se "*ligji është interpretuar dhe aplikuar në mënyrë qartazi të gabuar*" duke rezultuar në "*konkluzione arbitrare*" apo "*qartazi të paarsyeshme*" për parashtruesit përkatës, detyra e saj është të vlerësojë nëse procedurat para gjykatave, në tërësinë e tyre, janë në përpuethshmëri me Kushtetutën dhe KEDNJ-në. (Përkitazi me parimet themelore në lidhje me

interpretimin dhe aplikimin qartazi të gabuar të ligjit, shih ndër të tjera, rastin e Gjykatës KI154/17 dhe 05/18, parashtrues të kërkesës, *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "Barbas"*, cituar më lart, paragrafët 60 deri në 65 dhe referencat e përdorura në to).

40. Në këtë aspekt, Gjykata thekson se parashtruesja e kërkesës nuk argumenton se ligji i aplikueshëm në rastin e saj është interpretuar dhe aplikuar në mënyrë qartazi të gabueshme, dhe bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata konsideron se ky nuk është rasti në rrethanat e rastit konkret. Për më tepër, Gjykata thekson se procedurat para DHPGJS-së dhe Kolegjit të Apelit, në tërësinë e tyre, nuk ishin të padrejta apo arbitrare. (Shih, në këtë kontekst, edhe rastin e GJEDNJ-së *Shub kundër Lituaniës*, parashtrës nr. 17064/06, Vendimi për pranueshmëri i 30 qershorit 2009).
41. Në këtë kontest dhe më tej, Gjykata ndërlidhet me çështjen e dytë identifikuar më lart, përkatësisht faktin që pretendimet e parashtruara para Gjykatës, janë paraqitur gjithashtu para gjykatave të rregullta, të cilat ato i kanë shqyrtuar dhe arsyetuar.
42. Gjykata rikujton se ankesa e parashtrueses së kërkesës kundër Aktgjykimit [C-IV-13-1641] të 9 tetorit 2015 të Kolegjit të Specializuar në Kolegjin e Apelit ishte parashtruar jashtë afatit njëzet e një (21) ditore të përcaktuar përmes Ligjit për DHPGJS-në dhe theksuar në këshillën juridike të Aktgjykimit përkatës. Më specifikisht, parashtruesja e kërkesës e kishte pranuar Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar më 27 janar 2016, ndërsa kishte parashtruar ankesën në Kolegjin e Apelit më 24 shkurt 2016. Si rezultat, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, përmes Aktvendimit [AC-I-16-0038] të 2 majit 2019, e hodhi poshtë ankesën e parashtrueses si të papranueshme duke e arsyetuar pasafatshmërinë e saj dhe faktin që parashtruesja e kërkesës nuk *"ka paraqitur asnjë fakt apo provë me të cilën do të arsyetonte vonesën e saj"*. Më specifikisht, Aktvendimi përkatës thekson si në vijim:

"Sipas nenit 10/6 të LDHP kundër Aktgjykimit/Aktvendimit të Kolegjit të specializuar të DHPGJS mund të parashtrohet ankesë me shkrim, Kolegjit të Apelit të DHPGJS brenda 21 (njëzet e një) ditëve nga dita e pranimit të Aktgjykimit. Sipas konfirmimit të pranimit, fletë kthesës, Aktgjykimi i ankimuar i është dorëzuar ankueses me 19/01/2016, ndërsa ankesa është parashtruar nëpërmjet postës me 27/01/2016. Dita e fundit për parashtrimin e ankesës ka qenë me 17/02/2016. Është evidente që ankesa është parashtruar 07 ditë pas kalimit të afatit ligjor dhe duhet të hedhet poshtë si e papranueshme. Ankuesja nuk ka paraqitur asnjë fakt apo provë me të cilën do të arsyetonte vonesën e saj."

43. Gjykata më tej vëren se meritat e pretendimeve të parashtrueses së kërkesës u shqyrtuan nga Kolegji i Specializuar, i cili përmes Aktgjykimit [C-IV-13-1641] të 9 tetorit 2015 refuzoi ankesën e parashtrueses së kërkesës si të pabazuar dhe vërtetoi Aktvendimin e Autoritetit të Likuidimit të AKP-së. Ky Aktgjykim, në thelb, adresoi të gjitha pretendimet e parashtrueses së kërkesës e që ndërlidhen me joligjshmërinë e pretenduar të (i) njoftimit të AKM-së; dhe (ii) Aktvendimit të Autoritetit të Likuidimit.

44. Përkitazi me të parën, ky Aktgjykim ndër të tjera sqaroi se njoftimi i AKM-së është bërë në përputhje me paragrafin 3d të nenit 43 dhe nenin 49 të Rregullores 2005/48, duke theksuar si në vijim:

“Në bazë të nenit 49 të Rregullores së UNMIK-ut 2005/48 “Mbi Riorganizimin dhe Likuidimin e Ndërmarrjeve dhe pasurisë së tyre me autorizimin administrativ të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit”, e cila në atë kohë ishte në fuqi, njoftimet dhe shpalljet publike bëheshin si vijon:

a) Në gjuhën shqipe në një gazetë shqiptare dhe në gjuhën serbe në një gazetë serbe, të dyja me tirazh të madh në Kosovë dhe

b) Në gjuhën serbe në një gazetë serbe me tirazh të madh në Serbi dhe në Mal të Zi.”

“Me këtë AKM-ja e kishte kryer obligimin ligjor në drejtim të informimit të të gjithë kreditorëve potencial që pretendonin se kishin kërkesa kreditore ndaj kësaj NSH-je, dhe nuk ishte obligim ligjor i AKM-së që kreditorët ti njoftonte individualisht.”

45. Ndërsa, përkitazi me të dytën, përkatësisht pretendimet e parashtrueses së kërkesës lidhur me Aktvendimin e Autoritetit të Likuidimit, Kolegji i Apelit sqaroi se kërkesa e parashtrueses së kërkesës para AKM-së ishte paraqitur jashtë afatit. Siç është theksuar më lart, afati për dorëzimin e kërkesave sipas njoftimit të AKM-së ishte data 14 shkurt 2006, ndërsa parashtruesja e kërkesës e kishte paraqitur kërkesën e saj më 13 mars 2006. Për më tepër, Aktgjykimi kishte sqaruar se parashtruesja e kërkesës nuk ka paraqitur asnjë dëshmi që do të mund të arsyetonte vonesën përkatëse. Aktgjykimi në këtë kontekst, thekson si në vijim:

“Sipas provave që gjenden në shkresat e lëndës ndërmarrja “17 Nëntori” në Pejë ishte hyrë në proces të likuidimit. AKP kishte publikuar lajmërimin për parashtruesit e kërkesave dhe të gjithë kreditorët potencial të NSH “17 Nëntori” në Pejë (në likuidim) se afati për parashtrimin e kërkesave të Autoritetit të Likuidimit është deri me datën 14 shkurt 2006 dhe se ky publikim është bërë në shtypin ditor në gjuhët shqipe dhe serbe dhe në uebsajtin e AKM-së.”

“Nga provat që gjenden në shkresat e lëndës del se ankuesja kërkesën e saj, Autoritetit të Likuidimit ia kishte parashtruar me datë 13 mars 2006. Nga kjo del se ankuesja kërkesën te Autoriteti i Likuidimit e kishte parashtruar pasi që kishte kaluar afati i parashtrimin të kërkesave sipas informimit të publikuar nga AKM-ja. Ankuesja në ankesë, por as në përgjigjen ndaj mbrojtjes së parashtruar më vonë nuk ka sjellë asnjë dëshmi të besueshme që do ta justifikonte vonesën kaq të gjatë në parashtrimin e kërkesës te Autoriteti i Likuidimit, mandej ajo nuk e arsyeton fare vonesën”.

46. Prandaj, duke marrë parasysh sqarimet e lartcekura, Gjykata thekson se pretendimet e parashtrueses së kërkesës ishin trajtuar dhe sqaruar nga gjykatat e rregullta, dhe se në tërësinë e procedurës, nuk rezulton se gjykatat e rregullta kanë vepruar në mënyrë arbitrare apo të kenë interpretuar ligjin e aplikueshëm

në mënyrë arbitrare, për më tepër që, parashtruesja e kërkesës nuk ka dëshmuar dhe arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e saj për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ.

47. Gjykata gjithashtu thekson se bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së “*drejtësia*” që kërkohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së nuk është drejtësi “*substanciale*”, por drejtësi “*procedurale*”. Në terma praktik, dhe në parim, kjo shprehet me procedurë kontradiktore, ku palët dëgjohen dhe vendosen në të njëjtat kushte para gjykatës. (Shih, në këtë kontekst, rastin e Gjykatës KI42/16, me parashtrues *Valdet Sutaj*, Aktvendim për Papranueshmëri i 7 nëntorit 2016, paragrafi 41 dhe referencat tjera të përmendura aty).
48. Gjykata gjithashtu thekson se Kushtetuta dhe KEDNJ nuk i garantojnë askujt rezultat të favorshëm në proces gjyqësor dhe as nuk përcaktojnë që Gjykata, në parim, të vë në diskutim zbatimin e të drejtës materiale nga gjykatat e rregullta në një kontest civil, ku kryesisht njëra prej palëve fiton dhe tjetra humb. (Shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës KI118/17, *Şani Kervan dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, të 17 janarit 2018, paragrafi 36; dhe KI142/15, *Parashtrues Habib Makiqi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 1 nëntorit 2016, paragrafi 43).
49. Gjykata thekson se pakënaqësia e parashtrueses së kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendime të argumentueshme për shkeljen e të drejtave kushtetuese. (Shih, rastin e GJEDNJ-së *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).
50. Përkundrazi, është detyrim i parashtrueses së kërkesës që t'i mbështesë pretendimet e saj kushtetuese dhe të paraqesë prova *prima facie* që tregojnë për shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ. (Shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës nr. KI19/14 dhe KI21/14, me parashtrues të kërkesës, *Tafil Qorri dhe Mehdi Sylja*, Aktvendim për Papranueshmëri i 5 dhjetorit 2013, paragrafët 26 dhe 27).
51. Parimi i njëjtë vlen edhe për pretendimet e parashtrueses së kërkesës para Gjykatës përkitazi me shkeljet e pretenduara të neneve 7, 46, 49, 51 dhe 156 të Kushtetutës, përfshirë edhe referimin e parashtrueses së kërkesës për procedura të tejzgjatura gjyqësore; nenit 14 të KEDNJ-së dhe nenit 11 të Konventës për Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj Gruas. Gjykata thekson se parashtruesja e kërkesës pretendon shkelje të Kushtetutës, KEDNJ-së, dhe instrumenteve tjera ndërkombëtare, pa argumentuar dhe arsyetuar shkeljen e të njëjtave përmes Aktvendimit të kontestuar të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së. (Shih, ndër të tjera në këtë aspekt, rastin e Gjykatës nr. KI68/17, me parashtrues të kërkesës, *Hysni Bytyqi*, Aktvendim për papranueshmëri i 4 qershorit 2018, paragrafi 32). Ndërsa, në lidhje me pretendimet e parashtrueses së kërkesës për shkelje të neneve 1, 2 dhe 8 të Kartës Sociale Evropiane, Gjykata thekson se kjo e fundit, nuk është instrument ndërkombëtarë i garantuar përmes nenit 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të

Kushtetutës dhe rrjedhimisht, të drejtat e garantuara përmes saj nuk përbëjnë të drejta të garantuara me Kushtetutën e Kosovës, dhe për pasojë, Gjykata nuk ka juridiksion që të merret me vlerësimin e tyre.

52. Gjykata në këtë aspekt dhe për më tepër, thekson se fakti i thjeshtë që parashtruesja e kërkesës nuk është e kënaqur me rezultatin e Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së apo vetëm përmendja e neneve të Kushtetutës e instrumenteve tjera ndërkombëtare, nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse. (Shih, në këtë aspekt, rastin e Gjykatës KI136/14, *Abdullah Bajqinca*, Aktvendim për papranueshmëri i 10 shkurtit 2015, paragrafi 33).
53. Prandaj në këto rrethana, bazuar në si më sipër dhe duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesja e kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ajo, Gjykata duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton që parashtruesja e kërkesës nuk ka dëshmuar dhe nuk ka mbështetur mjaftueshëm pretendimet e saj për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të saj të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ.
54. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, dhe duhet të shpallet e papranueshme bazuar në paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe të rregullave 39 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 7 nëntor 2019, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Gresa Caka Nimani
Gresa Caka-Nimani

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi
Arta Rama-Hajrizi

